

Ekskluzive

Ekskluzive | Ky është i dyshuari për vrasjen e rëndë në Malishevë – gruaja 24-vjeçare vdiq pasi çifti u gjet i plagosur në dhomën e gjumit



Sinjali.com

24 Gusht 2026 09:28



Një ngjarje e rëndë ka tronditur fshatin Kërvasari të Malishevës, ku një çift bashkëshortor është gjetur i plagosur me armë zjarri brenda dhomës së gjumit. Gruaja 24-vjeçare nuk arriti t'u mbijetojë plagëve dhe ndërroi jetë pak orë më vonë në QKUK, raporton ekskluzivisht Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë me dije se personi që po trajtohet si i dyshuar në këtë rast është **Egzon Bytyqi**, 26 vjeçar, ndërsa viktima është bashkëshortja e tij, J. B. 24 vjeçare.

Ngjarja ka ndodhur mbrëmë, më 23 gusht, rreth orës 23:00.

Policia fillimisht është njoftuar për një plagosje me armë zjarri në Kërvasari, me ç'rast në drejtim të vendngjarjes janë nisur menjëherë patrullat policore dhe ekipi i Emergjencës së QKMF-së në Malishevë.

Me të mbërritur në shtëpi, ekipet emergjente janë përballur me një skenë të rëndë.

Egzon dhe J. Bytyqi janë gjetur të plagosur me armë zjarri në dhomën e gjumit.

Të dyve u është ofruar menjëherë ndihma mjekësore dhe më pas janë dërguar me urgjencë në QKUK në Prishtinë për trajtim të mëtejshëm.

Por J.B. nuk ia doli.

Rreth orës 01:10, autoritetet janë njoftuar nga Emergjencia e QKUK-së se 24-vjeçarja kishte ndërruar jetë si pasojë e plagëve të marra.

Ndërkohë, në vendin e ngjarjes është gjetur edhe arma që dyshohet se është përdorur në rast, e cila është sekuestruar në kuadër të hetimeve.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, arma dyshohet se i përket babait të Egzon Bytyqit, i cili ka deklaruar se atë e posedon me leje.

Në vendngjarje kanë dalë hetuesit policorë, drejtues të Policisë, si dhe Prokurori i Shtetit nga Departamenti për Krime të Rënda.

Pas veprimeve të para hetimore dhe konsultimit me Prokurorin, rasti është iniciuar si "Vrasje e rëndë", ndërsa hetimet janë duke vazhduar për të zbardhur në tërësi se çfarë ndodhi brenda shtëpisë para se çifti të gjendej i plagosur.

Sipas të dhënave fillestare të rastit, familjarët kanë deklaruar se i dyshuari kishte punuar prej rreth katër vitesh në Gjermani dhe ishte kthyer në Kosovë rreth një muaj më parë. Ata kanë dhënë deklarime edhe lidhur me gjendjen e tij shëndetësore gjatë kohës së fundit.

Këto pretendime janë deklarime të familjarëve dhe jo konstatime përfundimtare të organeve kompetente, ndërsa pritet që edhe ky aspekt të verifikohet gjatë hetimeve.

Motivi dhe dinamika e saktë e ngjarjes ende nuk janë bërë të ditura.

Ajo që nisi si një thirrje për plagosje me armë zjarri tashmë po hetohet si vrasje e rëndë: një grua e re ka humbur jetën, ndërsa bashkëshorti i saj, i cili po ashtu u gjet i plagosur, po trajtohet si i dyshuar në rast.

Sinjali do t'ju mbajë të informuar me detaje të reja lidhur me rastin.

Shënim: Personat e apostrofuat në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtimi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera